



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 15.1 (e) dhe 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të sigurimit që personat e veçantë të cilët kryejnë detyra të caktuara të cilat ndikojnë në sigurinë e aviacionit, shërbimet e trafikut ajror ose operimet e aeroportit në Republikën e Kosovës iu përmbahen standardeve të kërkuara të sigurisë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 5/2011
PËR PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE TË NDALUARA PËR PERSONELIN QË
PUNON NË FUNKSIONET E NDJESHME PËR SIGURI TË AVIACIONIT

Neni 1
Fushëveprimi

Kjo rregullore do të aplikohet për të gjithë personelin në lidhje me:

- a) një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit apo aktivitet të ndjeshëm për siguri të aviacionit që ushtrohet apo kryhet në Republikën e Kosovës, dhe
- b) një funksion fluturimi që ushtrohet në një avion të regjistruar në Kosovë.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje, shprehjet në vazhdim kanë këtë kuptim:

Alkool – do të thotë agjent dehës në pijet alkoolike, siç është birra, vera, rakia, likeri, alkooli etilik apo alkool tjetër me peshë të ulët molekulare, duke përfshirë metilin dhe alkoolin isopropil.

Aktivitet i ndjeshëm për siguri të aviacionit – do të thotë një aktivitet i cili për qëllim

të kësaj Rregulloreje është ndihmës për një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit.

Inspektor i AAC-së- nënkupton personelin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, të cilit ky titull i është dhënë pas përmbushjes së kushteve të nevojshme të parapara me Manualin e Cilësisë dhe Doracakun përkatës për Inspektor, dhe i cili është i autorizuar në bazë të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil apo Rregulloret e AAC-së të ushtrojë detyra mbikëqyrëse ndaj operatorëve ajrorë, pajisjeve të aviacionit dhe punëtorëve të aviacionit.

Funksion i fluturimit – do të thotë një funksion të përfshirë në kuadër të nenit 3.1 (a) deri në (f),

Personeli për shërbim në tokë – do të thotë personeli i punësuar apo i angazhuar në ofrimin e shërbimeve për shfrytëzuesit e aeroportit nëpër aeroporte ashtu si përshkruhet në Aneksin 1 të Rregullores së AAC-së Nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

Spital ose klinikë mjekësore – do të thotë një institucion që ofron trajtim mjekësor apo kirurgjik për pacientët e shtrirë dhe ata të jashtëm.

Avion i regjistruar në Kosovë – do të thotë një avion i regjistruar në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

Ligji për policinë – do të thotë Ligji nr. 03/L-045 për Policinë (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Zyrtar policor- nënkupton zyrtarin nën betim të Policisë së Republikës së Kosovës të cilit i është dhënë autoriteti për të ushtruar autorizime policore në kryerjen e detyrave të tij/saj dhe i cili është i pajisur me pajisje për kryerjen e testit të alkoolit në frymëmarrje.

Autorizimet policore- do të thotë autorizimet e zyrtarit policor sipas Ligjit nr. 03/L-045 për Policinë;

Substancë e ndaluar – do të thotë opiodët, substancat organike që gjenden në kanabis (cannabinoide), dhe psikostimulantët tjerë siç janë sedativët, mjetet hipnotizuese, halucinantët dhe tretësit e avullueshëm apo çfarëdo substance tjetër dehëse që ka për qëllim të ndikojë në strukturë apo çfarëdo funksioni të trupit të njeriut.

Kundërvajtje – sipas kësaj rregulloreje, do të thotë paraqitja në detyrë në funksionin e ndjeshëm për siguri të aviacionit apo në një funksion ndihmës të tij, gjatë gjendjes së paaftë për shkak të përdorimit të pijeve alkoolike dhe/apo substancave të ndaluara. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, koha në gjendje gatishmërie do të konsiderohet si kohë në detyrë.

Fjalët që shprehin gjininë do të përfshijnë edhe gjininë tjetër dhe fjalët që shprehin

numrin njëjës do të përfshijnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas.

Neni 3 **Funksionet e ndjeshme për siguri të aviacionit**

3.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje, funksionet e ndjeshme për siguri të aviacionit janë:

- a) ushtrimi i detyrës së pilotit në një avion në fluturim;
- b) ushtrimi i detyrës së navigatorit të fluturimit të një avioni në fluturim;
- c) ushtrimi i detyrës së inxhinierit të një avioni në fluturim;
- d) ushtrimi i detyrës së operatorit radiotelefonik të fluturimit të një avioni në fluturim;
- e) ushtrimi i detyrës së anëtarit të ekuipazhit të kabinës të një avioni në fluturim;
- f) pjesëmarrja në kabinën e fluturimit të një mjeti ajror gjatë fluturimit për të ofruar apo mbikëqyrur trajnimin, për të administruar një test, për të vëzhguar një periudhë të praktikës apo për të monitoruar apo regjistruar marrjen e përvojës;
- g) ushtrimi i detyrës së kontrollorit të trafikut ajror
- h) ushtrimi i detyrës së inxhinierit të licencuar për mirëmbajtjen e avionit.

3.2 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, aktivitetet e ndjeshme të sigurisë së aviacionit janë:

- a) ushtrimi i detyrës së koordinatorit të sigurimit në tokë;
- b) ushtrimi i detyrës së operatorit të skenuesit të sigurimit (*security screener*); dhe
- c) ushtrimi i detyrës së personelit të shërbimeve në tokë.

3.3 Për qëllim të paragrafit 1 pika (h), një person ushtron detyrën e inxhinierit të licencuar për mirëmbajtjen e avionit nëse:

- a) ai lëshon një dokument që ka të bëjë me mirëmbajtjen, gjendjen apo përdorimin e një avioni ose pajisjeje në mbështetje të licencës që i është dhënë sipas apo duke u mbështetur në një miratim në lidhje me aviacionin; ose
- b) ai kryen apo mbikëqyr punën e një avioni apo pajisjeje me qëllim të, apo në lidhje me lëshimin nga ai të një dokumenti të specifikuar në pikën (a) të

këtij paragrafi.

3.4 Referenca në ndonjë aktivitet që është ndihmës për funksionin e ndjeshëm për siguri të aviacionit është referencë në gjithçka që trajtohet si e tillë në mbështetje të paragrafëve 5 deri në 7 të këtij neni.

3.5 Një aktivitet do të trajtohet si ndihmës për një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, nëse ndërmerret:

- a) nga një person i cili është paraqitur në detyrë në lidhje me atë funksion, dhe
- b) si kërkesë për, për qëllim të ose në lidhje me, kryerjen e një funksioni të ndjeshëm për siguri të aviacionit gjatë periudhës në detyrë.

3.6 Një person, i cili në përputhje me kushtet e punësimit apo të marrëveshjes është i gatshëm të kryejë një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, nëse thirret, do të trajtohet sikurse kryen një aktivitet ndihmës për atë funksion.

3.7 Kur një person fillon të kryejë një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, çfarëdo që bën ai gjatë përgatitjes për të kryer funksionin, do të trajtohet si aktivitet ndihmës për atë funksion.

3.8 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, nuk është relevante nëse një person kryen një funksion apo ndërmerr një aktivitet në kuadër të një kontrate punësimi apo duke qenë i angazhuar ndryshe.

Neni 4 **Limiti i caktuar i alkoolit**

4.1 Një person shkakton kundërvajtje nëse:

- a) kryen një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit gjatë kohës kur përqindja e alkoolit në frymën, gjakun apo urinën e tij tejkalon limitin e caktuar; ose
- b) kryen një aktivitet i cili është ndihmës për një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit gjatë kohës kur përqindja e alkoolit në frymën, gjakun apo urinën e tij tejkalon limitin e caktuar.

4.2 Limiti i caktuar i alkoolit në lidhje me funksionet e ndjeshme për siguri të aviacionit të përshkruara në nenin 3.1 pika (a) deri në (g) është:

- a) në rast të frymës, 9 mikrogramë alkool në 100 mililitra;
- b) në rast të gjakut, 20 miligramë alkool në 100 mililitra; dhe

c) na rast të urinës, 27 miligramë alkool në 100 mililitra.

4.3 Limiti i caktuar i alkoolit, në lidhje me një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit të përshkruar në nenin 3 paragrafi 1 pika (h) dhe një aktivitet të ndjeshëm për siguri të aviacionit i përshkruar në paragrafin 2 pika (a) deri në (c) të atij neni, është:

- a) në rast të frymës, 35 mikrogramë alkool në 100 mililitra;
- b) në rast të gjakut, 80 miligramë alkool në 100 mililitra; dhe
- c) në rast të urinës, 107 miligramë alkool në 100 mililitra.

Neni 5

Paaftësia për detyrë

5.1 Një person konsiderohet i paaftë për detyrë, nëse ai person konsumon alkool tej limitit të caktuar, dhe/apo substanca të ndaluara, brenda tetë (8) orëve para paraqitjes në detyrë.

5.2 Një person kryen kundërvajtje nëse:

- a) kryen një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, gjatë kohës kur aftësitë e tij për kryerjen e funksionit janë të dobësuara për shkak të konsumimit të alkoolit tej limitit të caktuar dhe/apo substancave të ndaluara; ose
- b) kryen një aktivitet i cili është ndihmës për një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, gjatë kohës kur aftësitë e tij për kryerjen e funksionit, janë të dobësuara për shkak të konsumimit të alkoolit tej limitit të caktuar dhe/apo substancave të ndaluara; ose
- c) konsumon alkool tej limitit të caktuar dhe/apo substanca të ndaluara brenda gjashtë (6) orëve pas përfundimit të detyrës, nëse sjellja në punë mund të çojë deri te një hetim apo marrje në pyetje për, apo në lidhje me, përfshirjen e tij në ndonjë ndodhi të paraparë në nenin 7.1 (c) dhe (d).

Neni 6

E drejta e hyrjes

6.1 Zyrtarët policorë mund të hyjnë në një avion nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit për ushtrimin e autorizimeve të dhëna sipas nenit 7 dhe nenit 8 të kësaj Rregulloreje, lidhur me një person i cili është apo i cili mund të jetë në avion.

6.2 Zyrtarët policorë mund të hyjnë në çdo vend nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit për ushtrimin e autorizimeve të dhëna sipas nenit 7 dhe nenit 8 të kësaj Rregulloreje, lidhur me një person i cili është apo mund të jetë në atë vend.

6.3 Për qëllim të hyrjes në avion apo hyrjes në ndonjë vend sipas këtij neni, zyrtarët policorë:

- a) mund të përdorin forcën e arsyeshme sipas ligjit për policinë;
- b) duhet të shoqërohen gjatë tërë kohës nga Inspektori i AAC-së.

Neni 7

Kryerja e testeve

7.1 Zyrtarët policorë duhet që, pas kërkesës së Inspektorit të AAC-së, të kërkojnë nga cilido person që t'i nënshtrohet një testi të frymës në vendin e ngjarjes dhe/apo të kërkojnë nga personi në fjalë t'i nënshtrohet testeve të gjakut dhe urinës në një klinikë mjekësore më të afërt, për të përcaktuar limitin e caktuar, kur:

- a) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit se personi ka tejkaluar limitin e caktuar të dhënë më lart në nenin 4, ose aftësitë e tij/saj për kryerjen e funksionit të ndjeshëm për siguri të aviacionit apo ndonjë funksioni të tij ndihmës, janë të dobësuar për shkak të përdorimit të alkoolit dhe/apo substancave të ndaluara;
- b) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit se personi ka tejkaluar limitin e caktuar, të dhënë më lart në nenin 4, apo është i paaftë për shkak të përdorimit të pijeve alkoolike dhe/apo substancave të ndaluara, dhe vazhdon të ketë alkool në trupin e tij/saj apo mbetet nën ndikimin e alkoolit dhe/apo substancave të ndaluara;
- c) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit se, personi i një avioni të përfshirë në një incident, incident serioz apo aksident i cili gjatë kohës së ndodhisë ishte duke kryer një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, apo një aktivitet ndihmës për një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, në lidhje me atë avion; ose
- d) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit se personi i një avioni të përfshirë në një incident, incident serioz apo aksident, ka kryer një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, apo një aktivitet ndihmës për një funksion të ndjeshëm për siguri të aviacionit, në lidhje me atë avion.

7.2 Çdo person, i cili pa arsye të mirëfilltë, dështon t'i nënshtrohet testit të frymës dhe/apo dështon t'i nënshtrohet testit të gjakut apo urinës në një klinikë mjekësore më të afërt, kur atij i kërkohet nga zyrtari policor dhe/apo Inspektori i AAC-së në

mbështetje të këtij neni, kryen kundërvajtje dhe e bëjnë veten të paaftë për kryerje të detyrës.

Neni 8

Ndalimi pa urdhër

8.1 Zyrtarët policor mundën që pas kërkesës nga ana e Inspektorit të AAC-së, të ndalojnë një person pa urdhër, nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të dyshimit se personi:

- a) është duke kryer kundërvajtje sipas nenit 5.2 (a), (b) dhe vazhdon të jetë nën ndikimin e alkoolit dhe/apo substancave të ndaluara; dhe
- b) dështon t'iu përmbahet urdhrave që i janë dhënë nga Inspektori i AAC-së dhe zyrtarët policorë.

8.2 Asnjë person nuk mund të ndalohet sipas dispozitave të këtij neni gjatë kohës së trajtimit mjekësor si pacientë i shtrirë në spital.

8.3 Ndalimi i paraparë me këtë nen i nënshtrohet dispozitave përkatëse për autorizimet policore të dhëna në ligjin e zbatueshëm për policinë.

Neni 9

Dispozitat ndëshkuese

9.1 Personat që gjenden fajtorë për ndonjë kundërvajtje sipas kësaj Rregulloreje do të jenë përgjegjës dhe do t'iu nënshtrohen dispozitave ndëshkuese të Kreut IV të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i cili përfshin:

- a) lëshimin e një gjobe administrative nga AAC-ja në një shumë prej së paku 500 Euro por e cila nuk tejkalon maksimumin e parashikuar me ligj, për personat e përshkruar këtu në nenin 3.1 pikat (a) deri në (h); ose
- b) lëshimin e një gjobe administrative nga AAC në një shumë deri në 500 Euro, për personat e përshkruar në nenin 3.2 pikat (a) deri në (c); dhe
- c) së bashku me gjobën e lëshuar sipas pikës (a) ose (b), revokimin apo suspendimin për një periudhë të caktuar apo pacaktuar të certifikatës, lejes apo licencës së lëshuar nga AAC.

9.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shkelja e dispozitave përkatëse të kësaj Rregulloreje, mund të çojë në përgjegjësi penale në përputhje me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore shfuqizon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2004/09 të datës 13 maj 2004, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/5 mbi rregullimin e përkohshëm të aviacionit civil në Kosovë.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 qershor 2011.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm